



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, 2020

PËR

**PRIVATIZIMIN E OBJEKTEVE DHE SIPËRFAQEVE NDËRTIMORE NËN
OBJEKTET E DHËNA PËR STREHIM, NË INVENTAR TË MINISTRISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

1. Të gjitha objektet ndërtimore, së bashku me truallin nën objekt, të shndërruara në objekte banimi, dhënë për strehim ushtarakëve e ish-ushtarakëve nga Ministria e Mbrojtjes, privatizohen në favor të përfituesve që disponojnë dokumentacion për pajisjen me këto objekte dhe janë banorë aktualë të tyre.

Neni 2

Ish-pronarëve, të cilëve u është njohur e drejta e parablerjes, pasi objekti është ndërtuar mbi truallin e tyre, u njihet e drejta e kompensimit për sipërfaqen e truallit që privatizohet.

Neni 3

1. Privatizimi kryhet për ato objekte ndërtimore, që në bazë të akteve ligjore e nënligjore për kthim në banesa të objekteve që mbetën të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura, janë dhënë për strehim ushtarakëve dhe ish-ushtarakëve.

2. Privatizimi i objekteve ndërtimore dhe i truallit nën objektet që janë në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes, kryhen sipas listës bashkëlidhur, që përcakton numrin, emërtimin dhe vendndodhjen e pronës.

Neni 4

1. Dokumentacioni vërtetues i pajisjes së personave me objekt për qëllim strehimi është:

- a) autorizim nga komisionet e strehimit;
 - b) listë shpërndarje nga komisioni i strehimit apo nga Ministria e Mbrojtjes;
 - c) urdhër i ministrit të Mbrojtjes për strehim;
 - ç) shkresë drejtuar Entit Kombëtar të Banesave;
 - d) autorizim nga komandat e reparteve për strehim;
 - dh) autorizim i përkohshëm nga komandat e reparteve për strehim;
 - e) kontratë ruajtje ndërmjet poseduesit dhe komandës së repartit;
 - ë) urdhër ruajtje nga komanda e repartit që ngarkon poseduesin për ruajtjen e objektit;
 - f) urdhër për strehim të përkohshëm nga komanda e repartit;
 - g) kontratë provizore ndërmjet poseduesit dhe komandës së repartit;
 - gj) kontratë qiraje ndërmjet poseduesit dhe komandës së repartit;
 - h) vendim nga komisionet e strehimit.
2. Dokumentacioni i disponuar nga përfituesit duhet të jetë origjinal ose i njësuar me origjinalin.

Neni 5

1. Objektet ndërtimore, së bashku me truallin nën objekt, të shndërruara në objekte banimi, sipas nenit 1 të këtij ligji, i kalojnë ministrisë përgjegjëse për strehimin për Entin Kombëtar të Banesave me qëllim privatizimi.

2. Privatizimi i objekteve dhe truallit nën objekt kryhet nga Enti Kombëtar i Banesave, brenda tri viteve nga kalimi në përgjegjësi administrimi të objekteve nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 6

Privatizimi dhe regjistrimi i objekteve të dhëna për strehim do të kryhet nëpërmjet dokumentacionit, të llojit planvendosje dhe planimetri të përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 7

Privatizimi i objekteve të bëhet sipas gjendjes faktike të ndërtesës, duke përfshirë ndërtimet e reja, ndryshimet/ndërtimet e kryera në funksion të përshtatjes së objekteve për banim, si dhe duke përditësuar inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit, që administrohen nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 8

Përfshihen nga procedura e privatizimit, sipas këtij ligji, të gjithë ata persona që disponojnë një objekt tjetër banimi të përfituar nga shteti ose që në momentin e pajisjes me objekt për strehim kanë pasur detyrimin për të dorëzuar një objekt tjetër banimi dhe nuk e kanë dorëzuar.

Neni 9

Në rastet kur pala e interesuar njofton Entin Kombëtar të Banesave se gjykata është duke shqyrtuar një mosmarrëveshje me objekt marrëdhëniet e pronësisë mbi pasurinë që synohet të privatizohet, procedura e privatizimit pezullohet deri me marrjen e vendimit të formës së prerë.

Neni 10

Përfituesit e këtyre objekteve për privatizim nga Enti Kombëtar i Banesave do të paguajnë vetëm vlerën e truallit nën objekt, sipas vlerës së çmimit që ka pasur trualli në momentin e pajisjes së ushtarakut, ish-ushtarakut me dokumentacion për qëllim strehimi dhe shpenzimet hipotekore.

Neni 11

Objekt i privatizimit, sipas këtij ligji, janë vetëm pronat në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes që janë jashtë Planit të Vendosijes dhe të Përhapjes së Forcave të Armatosura.

Neni 12

Procedura e detajuar dhe dokumentacioni i nevojshëm për privatizimin e objekteve të dhëna për strehim përcaktohen me një udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Mbrojtjes.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz Ruçi